



**VLERËSIMI KOMBËTAR I RISKUT TË PASTRIMIT TË PARAVE  
DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT  
NË SHQIPËRI**

**VERSIONI PUBLIK**

**DHJETOR 2023**

## PËRMBAJTJA

<b>I.VLERËSIMI I RISKUT TË PASTRIMIT TË PARAVE SIPAS VEPRAVE PENALE</b>	<b>9</b>
<b>II.VLERËSIMI I RISKUT TË PASTRIMIT TË PARAVE SIPAS SUBJEKTEVE ....</b>	<b>9</b>
2.1 Personat Juridik (PJ) dhe marrëveshjet ligjore vendase .....	9
2.2 Individë rezident .....	10
2.3 Persona të Ekspozuar Politikisht (shqiptarë/të huaj) .....	11
2.4 Personat jo rezident (personat juridik, individë dhe marrëveshje ligjore të huaja) ..	11
<b>III: VLERËSIMI I RISKUT TË PASTRIMIT TË PARAVE SIPAS SEKTORIT EKONOMIK.....</b>	<b>12</b>
<b>IV: VLERËSIMI I RISKUT TË PASTRIMIT TË PARAVE SIPAS SEKTORIT/PRODUKTIT FINANCIAR .....</b>	<b>12</b>
4.1 Sektori bankar .....	12
4.2 Tregu i Kapitalit dhe Fondeve .....	14
4.3 Tregu i sigurimeve.....	15
4.4 Sektori financiar jobankë.....	16
4.5 Mjetet Virtuale dhe Paraja elektronike .....	17
4.6 Bizneset dhe profesionet jofinanciare .....	19
4.6.1 Truste ose Kompanitë e ofrimit të shërbimeve.....	19
<b>V: RISKU NGA FINANCIMI I TERRORIZMIT .....</b>	<b>21</b>
5.1 Panoramë e Përgjithshme .....	21
5.2 Sektori i Organizatave jofitimprurëse (OJF) .....	21
5.3 Masat për zbutjen e risqeve në sektorin e OJF në vendin tonë.....	22
5.4 Konkluzione për riskun e abuzimit/keqpërdorimit të OJF për financim terrorizmi .	23
5.5 Cënueshmëria e përgjithshme e sistemit në kuadër të risqeve të terrorizmit dhe financimit të terrorizmit .....	23
5.6 Konkluzione për riskun e terrorizmit dhe financimit të terrorizmit .....	25
<b>VI: ARMËT E SHKATËRRIMIT NË MASË.....</b>	<b>26</b>
6.1 Masat zbutëse .....	26
6.2 Risku i mbetur dhe konkluzione .....	27

## PARATHËNIE

Ky dokument përbën një përmbledhje të Vlerësimit Kombëtar të Riskut për pastrimin e parave (PP), financimin e terrorizmit (FT) dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, duke synuar të identifikojë kërcënimet, dobësitë dhe risqet, më të rëndësishme me cilat përballlet vendi ynë.

Vlerësimi Kombëtar i Riskut është një nga mjetet kryesore që përdoret nga vendet për të identifikuar rreziqet me të cilat mund të përballen, për të zhvilluar një kuptim të qartë rreth tyre dhe përbën bazën për marrjen e masave të qarta dhe ndërtimin e strategjive për adresimin e tyre.

Për Shqipërinë ky është vlerësimi i katërt kombëtar i riskut dhe është bazuar në metodologjinë e Këshillit të Evropës të cilët gjejmë rastin t'i falenderojmë për mbështetjen në të gjitha fazat e procesit.

Nëpërmjet dokumentit të vlerësimit të riskut synohet të vlerësohet niveli i ekspozimit ndaj PP/FT<sup>1</sup> në nivel kombëtar, të përcaktohen nivelet e riskut sipas veprave penale, subjekteve, sektorëve, produkteve, faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në këto risqe.

Kryerja e këtij vlerësimi është kyç për përcaktimin e politikave shtetërore në fushën e PP/FT, pasi nëpërmjet risqeve të identifikuara nga ky vlerësim, analizimi në detaje i niveleve të riskut dhe pasojat e tij në fusha të caktuara apo në ekonominë e një vendi orienton autoritetet përgjegjëse mbi përdorimin e instrumenteve të duhura ligjore, fushatave sensibilizuese/trajnuese për parandalimin dhe zvogëlimin e riskut nga PP/FT.

Vlerësimi shërben si një nga mekanizmat orientues për risqet madhore të identifikuara në nivel vendi dhe ndër të tjera shërben për të orientuar punën e subjekteve raportuese në përmbushjen e detyrimit të parashikuar në nenin 11<sup>2</sup> të ligjit PP/FT për identifikimin e risqeve të tjera specifike për klientët, vendet apo zonat gjeografike, produktet, shërbimet, transaksionet apo kanalet e shpërndarjes.

---

<sup>1</sup> Pastrimit të parave/Financimit të terrorizmit.

<sup>2</sup> Në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, subjektet kanë detyrimet e mëposhtme: **a/1)** të identifikojnë, të vlerësojnë dhe të kuptojnë rreziqet e tyre të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për klientët, vendet apo zonat gjeografike, produktet, shërbimet, transaksionet apo kanalet e shpërndarjes. Për realizimin e këtij parashikimi kërkohet që subjektet: i) të dokumentojnë vlerësimet e tyre të riskut; ii) të marrin në konsideratë të gjithë faktorët e riskut, përpara se të përcaktojnë nivelin e përgjithshëm të rrezikut, nivelin dhe llojin e masave zbutëse që duhet të zbatohen; iii) të marrin në konsideratë vlerësimet kombëtare të riskut, vlerësimet sektoriale, të dhëna të tjera të ngjashme, si dhe rekomandimet e autoritetit përgjegjës dhe/ose autoriteteve mbikëqyrëse; iv) të mbajnë të përditësuara vlerësimet e kryera; v) të ngrenë mekanizma të përshtatshëm për të ofruar vlerësimet e riskut të kryera për autoritetet përgjegjëse, autoritetet mbikëqyrëse, si dhe organe të tjera të përcaktuara me ligj; **a/2)** të marrin masa shtesë për të menaxhuar dhe zbutur rreziqet e larta kur identifikohen.

Dokumenti është një burim i rëndësishëm që sektori publik dhe privat mund ta përdorë për të kuptuar mjedisin aktual të të ardhurave të paligjshme dhe për t'u marrë në konsideratë në miratimin dhe zbatimin e politikave të tyre për zbutjen e risqeve të tyre.

Në hartimin e këtij dokumenti në nivel vendi janë përfshirë një sërë institucionesh<sup>3</sup>, të cilët kanë luajtur një rol të një rëndësie të veçantë për të identifikuar rreziqet e PP/FT me të cilat Shqipëria duhet të përballet.

Në kuadër të realizimit të Vlerësimit Kombëtar të Riskut, janë mbajtur takime ndër-institucionale dhe konsultime me subjekte të ligjit, autoritetet mbikëqyrëse apo grupe interesi.

---

<sup>3</sup> Agjencia e Inteligjencës Financiare, Banka e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruar dhe Konfiskuara, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Instituti i Statistikave Shtetërore (INSTAT), Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, Qendra Kombëtare e Biznesit, si dhe subjektet e ligjit rast pas rasti.

## PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Ky dokument është realizuar në përmbushje të një detyrimi që rrjedh nga Rekomandimi 1<sup>4</sup> i FATF<sup>5</sup>, rekomandime të cilat njihen si standard unifikues në nivel botëror. Gjithashtu vendi ynë ka marrë përsipër zbatimin e këtij detyrimi në kuadër edhe të ratifikimit të Konventës së Varshavës<sup>6</sup>, si dhe kërkohet nga ‘Direktiva nr. 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 20 maj 2015 ‘Mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit’’<sup>7</sup>.

Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit vazhdon të jetë e një rëndësie të posaçme për vendin tonë dhe Shqipëria mbetet e përkushtuar ndaj parandalimit, zbulimit dhe ndjekjes penale të PP dhe FT, duke vendosur një kuadër të përshtatshëm ligjor dhe institucional për të mbikëqyrur, mbledhur informacione dhe për të ndjekur penalisht personat dhe subjektet e përfshira në aktivitete kriminale.

Në të njëjtën kohë, është e kuptueshme nevoja për të forcuar më tej sistemin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për të përballuar ndryshimin e mjedisit kriminal. Në këtë drejtim, përditësimi i vlerësimit të riskut është një hap i domosdoshëm për të identifikuar dhe vlerësuar kërcënimet dhe dobësitë e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për vendin tonë.

Ky vlerësim risku është produkt i përpjekjeve të përbashkëta të agjencive të zbatimit të ligjit dhe inteligjencës, organeve mbikëqyrëse, autoriteteve të tjera qeveritare, si dhe sektorit privat, duke pasqyruar informacionin dhe kontributin e përcjellë prej tyre. Burimet e informacionit përfshijnë gjithashtu raportet publike kombëtare dhe ndërkombëtare në fushat përkatëse, duke përfshirë ato të publikuara nga Europol, FATF, Komiteti Moneyval i Këshillit të Evropës, si dhe Vlerësimi i Riskut të PP dhe FT të Komisionit Evropian. Ky dokument është një mjet i vlefshëm për autoritetet kompetente brenda vendit si dhe sektorin privat, për të kuptuar më mirë rreziqet e PP/TF, mbështetur vlerësimet e tyre të riskut,

---

<sup>4</sup> Vendet duhet të identifikojnë, vlerësojnë dhe të kuptojnë rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për vendin dhe duhet të marrin masa, duke përfshirë caktimin e një autoriteti ose mekanizmi për të koordinuar veprimet për vlerësimin e rreziqeve dhe të përdorin burimet, që synojnë sigurimin reduktimin e rreziqeve në mënyrë efektive. Vendet duhet gjithashtu të identifikojnë, vlerësojnë dhe kuptojnë riskun nga përhapja e armëve të shkatërrimit në masë.

<sup>5</sup> “Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar” është një organ ndërqeveritar, përgjegjësia e të cilit është të përcaktojë standardet e të nxisë zbatimin efektiv të masave ligjore, rregullative dhe operacionale për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë e kërcënime të tjera që lidhen me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar.

<sup>6</sup> Ligj Nr. 9646, datë 27.11.2006 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe për Financimin e Terrorizmit”, neni 13 pika 1 (Masat për parandalimin e pastrimit të parave): 1. Çdo Palë do të marrë ato masa legjislative dhe masa të tjera të nevojshme për të vendosur një regjim të plotë të brendshëm rregullues dhe mbikëqyrës për të parandaluar pastrimin e parave dhe merr parasysh si duhet standardet e zbatueshme ndërkombëtare, duke përfshirë veçanërisht rekomandimet e miratuara nga Task Forca për Veprimin Financiar mbi Pastrimin e Parave (FATF).

<sup>7</sup> Neni 7: Çdo Shtet Anëtar do të ndërmarrë hapat e duhur për të identifikuar, vlerësuar, kuptuar dhe zbutur rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që ndikojnë në të, si dhe çdo shqetësim për mbrojtjen e të dhënave në këtë drejtim. Vlerësimi duhet të përditësohet.

kryerjen e aktiviteteve të vazhdueshme mbikëqyrëse, identifikimin, hetimin dhe ndjekjen e PP/FT.

Vlerësimi Kombëtar i Riskut bazohet në një analizë të rreziqeve të PP bazuar në komponentët sa vijon:

- Analiza e kërcënimeve sipas veprave penale që shërbejnë si burimi kryesor për sigurimin e të ardhurave kriminale;
- Analiza e kategorive të subjekteve (individ rezident, individ jo rezident, persona juridik rezident, person juridik jo rezident etj) që përfshihen në PP;
- Analiza e sektorëve ekonomikë më të cënueshëm lidhur me PP;
- Analiza e sektorëve financiarë dhe të profesioneve të lira, të cënueshëm për PP;
- Analiza e rreziqeve të FT.

Analizimi i legjislacionit të PPP/FT evidentoi se Shqipëria ka krijuar ka një kuadër ligjor të përshtatshëm për këtë fushë, në përputhje me Rekomandimet e FATF apo edhe Direktivat përkatëse Evropiane dhe nuk u konstatuan mangësi thelbësorë ligjore që mund të përbëjnë cënueshmëri për tu shfrytëzuar për pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit.

Më poshtë është paraqitur shkurtimisht një listë përmbledhëse e ngjarjeve kryesore të rrezikut të PP të identifikuar përmes këtij vlerësimi:

1. Pastrimi i të ardhurave nga një sërë veprash penale të kryera jashtë vendit (vepra penale të lidhura me trafikimin e lëndëve narkotike, apo edhe vepra penale të kryera nga krimi i organizuar<sup>8</sup>, vjedhja e pasurisë) dhe vepra penale të kryera brenda vendit (prodhim, kultivim, shitje të lëndëve narkotike, vepra penale në fushën tatimeve dhe doganave, vepra penale të kryera nga krimi i organizuar, korrupsioni dhe/ose shpërdorim detyre, falsifikimi, mashtrimi, vjedhja e pasurisë);
2. Pastrimi i të ardhurave nga mashtrimet (përfshirë mashtrimet kompjuterike dhe në fushën e investimeve në “platforma” investuese të pa licencuara), të kryera jashtë vendit ose në Shqipëri nga individë apo grupet e organizuara kriminale përmes përdorimit të sistemit financiar me pasojë transferimin e fondeve në juridiksione të tjera, tërheqjen në para cash;
3. Pastrimi i të ardhurave nga krimet që lidhen me fushën e tatimeve (fshehja e të ardhurave dhe mashtrimi i TVSH), duke përdorur personat juridik;
4. Pastrimi i të ardhurave nga korrupsioni përmes përdorimit herë pas here të palëve të treta (individë dhe persona juridik) që shërbejnë për të kamufluar mekanizmin, integrimi i mëvonshëm në instrumente financiare, pasuri të paluajtshme brenda vendit, apo biznese.

---

<sup>8</sup> Kryesisht veprat penale të lidhura me krimin e organizuar janë trafikimi i lëndëve narkotike, vjedhja, mashtrimi.

5. Pastrimi i parave duke përdorur persona juridikë rezident (kryesisht të formës sh.p.k<sup>9</sup> dhe më rrallë forma të tjera juridike) ose persona të tretë individë brenda ose jashtë rrethit të ngushtë të personit që është gjenerues i të ardhurave kriminale;
6. Përfshirja e mundshme e profesionistëve nëpërmjet dhënies së këshillave me qëllim mundësimin e procesit të pastrimit të parave.

Ngjarjet e riskut për financim terrorizmi/terrorizëm të identifikuar përmes këtij vlerësimi janë si më poshtë:

1. Risku i ekstremizmit dhe radikalizmit të cilat mund të mbështesin apo ushqejnë potencialisht veprimtaritë terroriste/financuese të terrorizmit;
2. Kërcënimi i mundshëm nga të rikthyerit nga zonat e konfliktit nëpërmjet përhapjes së ideologjive ekstremiste, përdorimi i përvojës së luftës në indoktrinimin e personave të tjerë, përhapja e tensioneve shoqërore<sup>10</sup>.

### **Subjektet:**

Individët rezident: Në Shqipëri, duke marrë në konsideratë materialitetin e vendit, vazhdojnë të jenë grupi më i madh i subjekteve të përfshira në aktivitete me potencial pastrimin e parave.

Skenarët e rrezikut më të lartë që lidhen me individët janë:

- Blerje pasurish në vlera të larta me burim të paqartë, të panjohur apo të pajustificuar të fondeve;
- Përfitimi i transfertave të shpeshta dhe në vlera të relativisht të vogla nga individë pa një lidhje të qartë mes tyre;
- Depozitimi në llogari bankare të shumave cash me burim paqartë, të panjohur apo të pajustificuar;
- Veprime financiare (depozitim/ transfertat/ investim në pasuri të paluajtshme/ luajtshme) nga persona të dyshuar si të përfshirë në veprimtari kriminale;
- Përdorimi i personave të tretë për transaksione dhe investime, pa precedent dhe lidhje të dukshme kriminale, në funksion të fshehjes origjinës së të ardhurave.

Personat juridikë rezident: Vazhdojnë të përfaqësojnë numrin e dytë më të madh të subjekteve të përfshirë në aktivitetin e mundshëm të PP, kryesisht me burim të ardhurash nga krime në fushën tatimore, mashtrimi, krimi i organizuar, korrupsioni ku skenarët kryesorë përfshijnë:

- Vendosja e fondeve në qarkullimin të formalizuar tregtar, me origjinë të paqartë, të panjohur apo të pajustificuar;

<sup>9</sup> Nisur kjo nga fakti se kjo lloj forme regjistrimi në vendin tonë është forma më e pëhapur e regjistrimit të subjekteve juridike.

<sup>10</sup> Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit dhe Planet e Veprimit.

- Investim në pasuri të paluajtshme në emër të shoqërive ekzistuese të zotëruar nga persona të dyshuar si të përfshirë në veprimtari kriminale, në vlera të pajustificuara me burime të deklaruara apo të ligjshme;
- Përfitimi i transfertave të larta në llogari biznesi të personit të dyshuar si i përfshirë në veprimtari kriminale nga shoqëri pa një lidhje të qartë mes shërbimit/mallit të ofruar dhe pagesës;
- Përfshirja e një individi të vetëm në disa subjekte, të cilat kanë të njëjtin objekt veprimtarie apo të njëjtën adresë dhe kryerja e transaksioneve pa një lidhje të qartë midis palëve të transaksionit;
- Transferta të dyshimta të përfituara në llogari të subjekteve tregtare, që nuk kanë aktivitet të mirëfilltë ekonomik të provueshëm me numër apo profil punonjësish të deklaruar, si dhe modelin e paraqitur të biznesit;
- Përdorimi i subjekteve juridike për qarkullimin e transfertave nga/me jashtë, të përfituara nëpërmjet skemave mashtruese.

Individët jo rezident: Skenarët kryesorë të lidhur me këtë kategori janë:

- Krijimi dhe regjistrimi i subjekteve juridikë rezidentë dhe përdorimi i llogarive të tyre bankare për marrjen apo dërgimin e transfertave nga/drejt juridiksioneve të ndryshme pa një lidhje të qartë me objektin e veprimtarisë së shoqërisë me dyshime të lidhura kryesisht me evazionin fiskal;
- Realizimi i investimeve kryesisht rezidenciale pa një burim të qartë të ardhurave.

PEP Rezident<sup>11</sup>: Për shkak të funksionit të tyre, dyshimet për rastet me PEP lidhen me “Shpërdorim detyre/Korrupsion”, me skenarë kryesorë si më poshtë:

- Investime në vlera të larta në një biznes mbas mbarimit të detyrës pa një burim të qartë të ardhurave apo edhe deklarimi i fitimeve të larta të menjëhershme nga një biznes i zotëruar, kontrolluar nga i lidhur me një ish PEP;
- Qarkullim fondesh të larta në llogaritë individuale nga PEP deklaruar nga biznesi, por të pajustificuara nga të ardhurat e biznesit;

---

<sup>11</sup> Sipas nenit 2 pika 10 e ligjit PP/FT PEP do të konsiderohen: a) Individët, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarin e pasurive të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, me përjashtim të nëpunësve të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues, pavarësisht nëse kanë detyrimin për deklarin sipas legjislacionit në fuqi për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë; b) Individët, të cilët kanë ose kanë pasur funksione të rëndësishme si brenda vendit apo jashtë vendit në një qeveri dhe/ose në një shtet të huaj, të tillë si: kryetar shteti dhe/ose qeverie, ministra, zëvendësministra ose pozicione të ngjashme me to, anëtarë të Kuvendit ose organeve legjislativ të ngjashme, politikanë të lartë, anëtarë të organeve drejtuese të partive politike, gjyqtarët e gjykatave të larta ose kushtetuese, si dhe çdo gjyqtar i një gjykate, ndaj vendimeve të së cilës nuk mund të ushtrohen mjetet e zakonshme të ankimit, anëtarët e organeve drejtuese të bankave qendrore, ambasadorët dhe të ngarkuarit me punë, si dhe oficerët me gradë madhore në Forcat e Armatosura, drejtuesit e lartë dhe/ose anëtarët e organeve drejtuese të shoqërive shtetërore, si dhe drejtorët, zëvendësdrejtorët ose anëtarët e bordit ose çdo pozicion tjetër i ngjashëm me to në një organizatë ndërkombëtare. Individët e përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike do të konsiderohen “persona të ekspozuar politikisht” deri në 3 (tre) vjet pas largimit nga funksioni.

- Investime në pasuri të paluajtshme mbas mbarimit të detyrës me burim të paqartë, të panjohur apo të pajustificuar;
- Investime në pasuri nga PEP me vlerë të deklaruar nën çmimin e tregut;

### **Sektorët ekonomik:**

Ky vlerësim identifikoi disa sektorë ekonomikë, të cilët janë të përdorur më shpesh për aktivitete të PP në faza të ndryshme. Sektorët ekonomikë më të ndjeshëm ndaj PP janë: Sektori i Pasurive të Paluajtshme, Ndërtim, Tregtia, Sektori i Shërbimeve Telematike (Call Center)<sup>12</sup>, Konsulenca në fushën ekonomike dhe ligjore. Skemat rast pas rasti përfshijnë edhe elementë ndërkombëtar, të krijuara qëllimisht apo edhe përfshirje të bizneseve ekzistuese, elementë të cilat synojnë të pengojnë identifikimin, gjurmimin e burimit dhe qëllimin përfundimtar të përdorimit të të ardhurave kriminale.

### **Përdorimi i sistemit financiar dhe jofinanciar:**

Për sa i përket përdorimit si kanal për rastet e dyshuara të pastrimit të parave ky vlerësim identifikoi se kanalet më të përdorur janë sistemi bankar dhe kategori të profesioneve të caktuara jofinanciare.

Ky rezultat bazohet në disa aspekte si natyra e ekonomisë në vendin tonë e cila përfshin kategori subjektsh tradicionalë dhe të përqendruar kryesisht në sektorin bankar, ndërkohë që subjektet e tjera financiare janë ende me zhvillim minimal krahasuar me bankat.

Përdorimi i sistemit bankar është përgjithësisht i pashmangshëm në një apo më shumë faza të pastrimit të parave (vendosja, shtresëzimi, integrimi), për shkak kjo të natyrës së qenësishme të operacionit bankar, zhvillimit të tij dominues në vendin tonë krahasuar me subjekte të tjera financiare, madhësisë dhe rëndësisë së tij, si dhe për shkak të numrit të madh të klientëve apo transaksioneve të kryera në emër të tyre. Ndërsa sektori bankar në parim ka një ekspozim të lartë ndaj rreziqeve të pastrimit të parave, vlerësohet se ka ndërgjegjësim të mirë dhe mjete të përshtatshme dhe për t'i zbuluar ato. Kjo është konfirmuar përveçse nga vlerësimet ndërkombëtare të fushës edhe nga një nivel i lartë raportimi të RAD ndër vite jo vetëm në nivel numerik por edhe sa i përket cilësisë së tyre. Kështu si indicie për informacionet e dërguara nga AIF në organet ligjzbatuese në mbi 90% të rasteve kanë shërbyer RAD e dërguara nga sektori bankar.

Profesioni i noterit është perceptuar dhe ka rezultuar edhe nga të dhënat si ndër më të cënueshmet krahasuar me subjektet/profesionet e tjera për shkak se noteri në Shqipëri ka një rol qendror, si dhe kryen një gamë të gjerë të veprimeve juridike (huadhënie, kontrata kredie,

---

<sup>12</sup> Në kuadër të këtij dokumenti risku i referohet subjekteve që kryesisht ushtrojnë veprimtari për investime në platforma të palicensuara (bursa fiktive, kriptomoneda etj).

çelje trashëgimie etj.), për pjesën më të madhe e të cilave është mundësia e vetme për veprimet, përfshirë këtu edhe transaksionet e pasurive të paluajtshme.

### **Produktet më të përdorura:**

Analizimi i të dhënave të disponueshme në kuadër të këtij vlerësimi tregoi se produktet më të përdorur për pastrimin e produkteve të veprës penale bazuar në analizë janë: transfertat hyrëse/dalëse me dhe nga jashtë vendit, tërheqje/depozitim i fondeve, transferimi i fondeve brenda vendit.

Për sa i përket përdorimit të transfertave bankare ndër karakteristikat që i bëjnë ato tërheqëse për rastet e pastrimit të parave janë: vështirësia për të monitoruar ose kontrolluar transfertat elektronike, në nivel të njëjtë me produkte të tjera bankare për shkak të vëllimit të transaksioneve; fondet mund të transferohen përmes juridiksioneve të ndryshme, në mënyrë që të humbasin gjurmët e burimit të fondeve, apo transferimet mund të bëhen nga një numër i madh llogarish bankare në depozitat që janë krijuar për të humbur gjurmët e llogarisë kryesore shpesh të vendosur jashtë vendit.

Për sa i përket përdorimit të parasë cash ndër karakteristikat që i bëjnë ato tërheqëse për rastet pastrimit të parave janë: fshehja e origjinës së të ardhurave dhe vështirësinë në gjurmimin e këtyre të ardhurave.

## **I. VLERËSIMI I RISKUT TË PASTRIMIT TË PARAVE SIPAS VEPRAVE PENALE**

Nga kryqëzimi i të dhënave të institucioneve përkatëse, rezulton se krimi i kryer jashtë vendit mbizotëron ndaj atij vendas për sa i përket krijimit të pasurive kriminale. Nga kryqëzimi i informacionit të AIF dërguar në Polici dhe Prokurori, referimet e Policisë së Shtetit në Prokurori, procedimet penale të regjistruara nga Prokuroritë, vlerësimet e institucioneve ligjzbatuese, institucioneve mbikëqyrëse dhe sektorit privat, rezultoi se 7 grup veprat kryesore të gjenerimit të të ardhurave kriminale, janë:

- Prodhim, Kultivim, Trafikimi i lëndëve narkotike;
- Vepra penale në fushën tatimeve dhe doganave;
- Krimi i Organizuar;
- Korrupsioni dhe/ose Shpërdorim detyre;
- Falsifikimi;
- Mashtrimi;
- Vjedhja e pasurisë.<sup>13</sup>

## **II. VLERËSIMI I RISKUT TË PASTRIMIT TË PARAVE SIPAS SUBJEKTEVE**

Marrë në konsideratë se Shqipëria nuk është qendër financiare as rajonale as më gjerë, në grupimin e klientëve ‘persona juridik’ dominojnë pothuajse në tërësi nga klientë rezident. Elementi jo rezident (individ dhe persona juridik jo rezident) nuk paraqet materialitet domethënës, pasqyruar kjo edhe nga të dhënat e strukturës së klientëve në subjektet e ligjit në të cilat rezulton se dominohet nga klientët rezidentë<sup>14</sup>.

Në këtë kontekst edhe rastet e raportuara si RAD, analizuara, investiguara, hetuara dhe me dënime, përfshijnë më së shumti persona rezident, qofshin këta juridik apo individ.

### **2.1 Personat Juridik (PJ) dhe marrëveshjet ligjore vendase<sup>15</sup>**

Referuar kuadrin ligjor për regjistrimin dhe funksionimin e personave juridik, tipologjive, rasteve të dyshimta, rezultoi se risku sipas llojit/formës ligjore të personit juridik është vlerësuar i njëjtë, duke marrë në konsideratë se:

- Nuk rezultojnë parashikime ligjore për regjistrimin e personave juridik në Shqipëri, me kërkesa të thjeshtuara në krahasim me të tjerët;

<sup>13</sup> Kjo vepër penale pavarësisht se ka numrin më të lartë të procedimeve të regjistruara nga prokuroria, jo domosdoshmërisht në të gjitha rastet është vepër gjeneruese për pastrimin e produkteve të veprës penale.

<sup>14</sup> P.sh. në banka numri i individëve jo rezident të cilët zotërojnë të paktën një llogari bankare përbëjnë 1.6% të numrit total të klientëve të sektorit bankar, numri i personave juridik jo rezident të cilët zotërojnë të paktën një llogari bankare në Shqipëri përbëjnë 0.01% të numrit total të klientëve të sektorit bankar, shoqëritë e auditimit raportojnë se 5% e klientëve janë jo rezident dhe kontabilistët raportojnë se 4% janë jo rezident).

<sup>15</sup> Legjislacioni i Shqipërisë nuk njeh trustet dhe nuk ka sistem për regjistrimin e trusteve dhe organizimet e tjera ligjore. Gjithashtu Shqipëria nuk ka aderuar në Konventën e Hagës për Trustet.

- Nuk rezultojnë lehtësira apo hapësira ligjore dalluese në lidhje me organizimin dhe funksionimin e personave juridik, të themeluar në Shqipëri, në mënyrë që një lloj personi juridik të jetë më i cënueshëm krahasuar me një tjetër;
- Asnjë nga format ligjore të personave juridik të themeluar në Shqipëri nuk shfaq tipare specifike/veçanta të cilat të lejojnë anonimitet të pronarit përfitues.

Për më tej, analizimi i kuadrit ligjor për regjistrimin dhe funksionimin e personave juridik i statistikave të disponueshme në nivel vendi (RAD, dërgime informacioni, referime, kallëzime), analizimi i informacioneve të rezultuara nga analiza sektoriale, analizimi i tipologjive, i masave në vend, tregoi se:

- Numri i subjekteve juridik të regjistruara në Shqipëri është relativisht jo problematik në terma numerik, pasi aktivë janë rreth 45,000 persona juridik;
- Legjislacioni i Shqipërisë nuk njih ‘trustet’ (apo organizma të tjera të ngjashme) dhe nuk ka sistem për regjistrimin e tyre. Gjithashtu, Shqipëria nuk ka aderuar në Konventën e Hagës për ‘Trustet’;
- Legjislacioni i Shqipërisë nuk parashikon mundësinë e lëshimit dhe regjistrimit të ‘aksioneve të mbajtësit’;
- Në pjesën dërmuese të rasteve të dhënat thelbësore për personat juridik janë të publikuara dhe mund të aksesohen nga cilido në faqen zyrtare të QKB;
- Ngritja, funksionimi dhe popullimi i regjistrimit për pronarin përfitues siç kërkohet nga direktivat e BE, ndikon në rritjen e transparencës së pronësisë së personave juridik.

Nga analizimi i materialitetit, marrë në konsideratë cënueshmërinë, masat reaguese, frekuencën dhe pasojat rezultojnë se personat juridik rezident paraqesin një nivel të lartë rrishtu.

## **2.2 Individë rezident**

Bazuar në të dhënat e analizuara në kuadër të këtij vlerësimi rezultoi se veprat penale më të shpeshta që individët rezident përdorin më tepër për gjenerimin e produkteve të veprës penale janë:

- “Prodhim, shitje, trafikim të lëndëve narkotike dhe lëndëve psikotrope” dhe fusha në të cilën pastrohen këto produkte është “pasuritë e paluajtshme”;
- “Vjedhje e pasurisë” dhe fusha në të cilën pastrohen këto produkte është “pasuritë e paluajtshme”;
- “Trafikimi i qenieve njerëzore ose shfrytëzim prostitucioni” dhe fusha në të cilën pastrohen këto produkte janë “pasuritë e paluajtshme”.

Ndërsa, produktet financiare të përdorura më tepër për tre veprat janë transfertat ndërkombëtare/brenda vendit hyrëse dhe dalëse, depozitimet cash dhe tërheqjet cash.

### **2.3 Persona të Ekspozuar Politikisht (shqiptarë/të huaj)**

Ligji për PPP/FT kërkon që subjektet të ndërmarrin hapa shtesë për të përcaktuar nëse klienti i tyre ose pronari përfitues i klientit të tyre, është një PEP dhe nëse ata janë PEP, të aplikohet masa për vigjilencën e zgjeruar për të zbutur rrezikun që mund të vijë nga pastrimi i të ardhurave me natyrë kriminale përfshirë këtu edhe korrupsionin.<sup>16</sup>

AIF ndan herë pas here me subjektet tipologji të reja të përdorura nga këta të fundit për pastrimin e produkteve të veprës penale.

Nga analizimi i materialitetit, marrë në konsideratë cënueshmërinë, masat reaguese, frekuencën dhe pasojat rezultojnë se Personat e Ekspozuar Politikisht (PEP) paraqesin një nivel të lartë risku.

### **2.4 Personat jo rezident (personat juridik, individë dhe marrëveshje ligjore të huaja)**

Sipas parashikimeve ligjore subjektet duhet t'u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me klientët jo rezidentë, të vlerësuara me risk të lartë. Nga përvoja e inspektimit apo administrimit të informacioneve në kuadër të analizimit të rasteve rezultojnë se kategoria jo rezident mbikëqyren me vigjilencë të zgjeruar.

Nga analizimi i materialitetit, marrë në konsideratë cënueshmërinë, masat reaguese, frekuencën dhe pasojat rezultojnë se individët jo rezident paraqesin një nivel mesatar risku, ndërsa personat juridik jo rezident paraqesin nivel të ulët risku.

Klasifikimi i mësipërm nuk nënkupton që nga ana e subjekteve të ligjit, kategoritë e klientëve të grupeve të mësipërme (individ rezident, jo rezident, persona juridik rezident, jo rezident, PEP) të klasifikohen në mënyrë automatike, pasi ky proces kryhet rast pas rasti bazuar në parashikimet ligjore në fuqi, procedurat e brendshme të secilit subjekt si dhe veçantitë apo specifikave që paraqet klienti apo transaksionet e kryera prej tij.

---

<sup>16</sup> Nenin 8 pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" i ndryshuar.

### **III: VLERËSIMI I RISKUT TË PASTRIMIT TË PARAVE SIPAS SEKTORIT EKONOMIK**

Në Shqipëri sektorët të cilët janë vlerësuar se zënë peshën kryesore në raport me PBB janë ‘Bujqësia, pyjet, peshkimi’, duke vijuar me ‘Tregtinë’, ‘Industrinë’, pastaj ‘Administrata publike, Arsimi, Shëndetësia & aktivitete të punës sociale’ dhe ‘Ndërtimi’.

Nga analizimi i materialitetit marrë në konsideratë cënueshmërinë, masat reaguese, frekuencën dhe pasojat, natyrën dhe karakteristikat e rasteve të investiguara, rezultojnë se sektorët që paraqesin risk më të lartë për t’u përdorur për pastrim parash, janë: sektori i pasurive të paluajtshme, sektori i ndërtimit, tregtia, sektori i shërbimeve telematike (call center) dhe shërbimet e konsulencës ekonomike, ligjore.

### **IV: VLERËSIMI I RISKUT TË PASTRIMIT TË PARAVE SIPAS SEKTORIT/PRODUKTIT FINANCIAR**

Nga analiza e sistemit financiar dhe jofinanciar, marrë në konsideratë natyrën e shërbimeve të ofruara, cënueshmërinë, masat reaguese, frekuencën, pasojat, natyrën dhe karakteristikat e rasteve të investiguara, konkludohet se ‘Subjektet bankare’ dhe ‘Bizneset dhe profesionet jofinanciare’ paraqesin një nivel të lartë risku për pastrim parash.

#### **4.1 Sektori bankar**

##### **▪ Materialiteti i sektorit bankar**

Sistemi bankar në Shqipëri në vitet e fundi nuk ka pasur ndryshime domethënëse strukturore. Në vitin 2023 numërohen në total 11 banka të nivelit të dytë dhe përqendrimi më i madh i këtyre degëve është në Tiranë, Durrës dhe Fier. Shpërndarja gjeografike e degëve/agjencive bankare lidhet me faktin e përqendrimit më të madh të popullsisë në këto qytete. Pësa që zë sistemi bankar në ekonomi, e shprehur nëpërmjet raportit të aktiveve ndaj PBB është në nivelin 91% për 6 mujorin e parë të 2023.

##### **▪ Produktet bankare**

Bankat në Shqipëri ofrojnë një gamë të gjerë produktesh dhe veprime financiare duke nisur nga huadhënie, depozita, investime letra me vlerë, transaksionet cash, transfertat midis llogarive (*brenda vendit/ndërkombëtare*), shërbimet e-banking të cilat kanë pasur një tendencë në rritje vitet e fundit në masën 29.7%<sup>17</sup>, përdorimi i kartave të kreditit/ debitit, etj. Produkti me peshën më të madhe në sistemin bankar është kredidhënia, vlera e të cilës është 3.5 herë më e lartë se vlera e kapitalit (184 mld lekë) të sistemit bankar, duke vijuar me depozitat<sup>18</sup> vlera e të cilave është 46.2 % e vlerës së kapitalit.

<sup>17</sup> Krahasim 2021 me 2022

<sup>18</sup> Këtu i referohemi vetëm depozitave të reja të vitit 2022.

## ▪ **Konkluzione**

Nga kryqëzimi i të dhënave të marra në analizë në kuadër të këtij vlerësimi, rezulton se produktet financiare më të cënueshme për t'u përdorur për pastrimin e parave, duke marrë në konsideratë frekuencën e përdorimit të produktit, gjurmueshmërinë, cënueshmërinë, karakteristikat e vetë produktit (anonimiteti), etj. janë: transferimi i fondeve (ndërkombëtare/vendase) dhe veprimet cash (depozitime/tërheqje), ndërkohë që kredidhënia është produkti i cili ka një vlerë të lartë të qarkulluar, por të dhënat tregojnë se kredia nuk është një produkt shumë i përdorur për pastrimin e produkteve të veprës penale. Shërbimet e-banking rezultojnë me tendencë rritje, por ende mbetet jo dominues krahasuar me produktet e tjera.

## ▪ **Cënueshmëria**

Spektori bankar përtej risqeve që paraqet, ka një nivel të lartë të ndërgjegjësimit për PP/FT dhe marrjen e masave për zbutjen e tyre. Ky sektor ka një marrëdhënie konstruktive me BSH dhe AIF.

Vlerësohet se ky sektor njeh risqet nga të cilave është i ekspozuar, duke marrë në konsideratë vlerësimet e riskut në nivel vendi, grupesh bankare, si dhe vlerësimet e tyre të brendshme të riskut.

Banka e Shqipërisë si institucion mbikëqyrës vlerëson se bankat e nivelit të dytë në përgjithësi kanë në vëmendje dhe kanë rritur përpjekjet për një administrim të përshtatshëm të riskut PP/FT, respektimin e kërkesave ligjore, rregullatore dhe të kuadrit të brendshëm rregullativ në këtë fushë.

AIF si institucion përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave, bazuar në statistikat e RAD të dërguara nga subjektet raportuese vlerëson se bankat e nivelit të dytë janë ndër subjektet më të ndërgjegjësuar për parandalimin e pastrimit të parave, reflektuar kjo edhe nga numri i lartë i RAD nga kjo kategori. Numri i lartë i RAD nuk tregon vetëm ndërgjegjësimin dhe efektivitetin e masave parandaluese, por edhe cënueshmërinë e tyre si kanal i përdorur. Megjithatë, si element bazueshmërie dyshimesh të evidentuara në RAD e marra, vlen të përmendet se në mbi 90 % të rasteve të dërguara për investigim të mëtejshëm nga AIF në organet ligjzbatuese ka indicie nga RAD e dërguara nga sistemi bankar.

## 4.2 Tregu i Kapitalit dhe Fondeve

Në Tregun e Fondeve të Investimit për vitin 2022 ushtrojnë aktivitetin e tyre 11 fonde investimi me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, të cilat administrohen nga pesë shoqëri administruese. Pesha që zë vlera e asetëve të këtyre subjekteve në raport me PBB është 1.94%. Tregu i fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike dominohet kryesisht nga investimet në obligacione dhe bono thesari të R.SH., të cilat përbëjnë rreth 75.93% të asetëve të këtij tregu.

### ▪ Risku i Tregut të Kapitalit dhe Fondeve

Duke qenë se tregjet e kapitalit dhe fondeve të investimeve në Shqipëri janë ende në fazat e para të zhvillimit rastet e raportuara me dyshime janë të thjeshta. Kryesisht elementët e dyshimit kanë qenë për burimin e fondeve të individëve/personave juridik që kanë investuar në këto shoqëri. Deri më tani nuk janë evidentuar skema të komplikuar ku të përfshihen produkte apo subjektet që tregtohen në tregjet e kapitalit dhe fondeve.

### Cënueshmëria

Tregu i kapitalit dhe fondeve vlerësohet se paraqesin rreziqe të ulëta, për shkak të nivelit shumë të kufizuar të zhvillimit në këta sektorë.

Shqipëria nuk ka një bursë funksionale, shumë nga firmat që kryejnë shërbime ndërmjetësimi/brokerimi janë ose të kufizuara në letrat me vlerë të qeverisë shqiptare ose janë agjentë të lidhur me një firmë tjetër brokerimi jashtë Shqipërisë.

Sipas një publikimi të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) për vendin tonë<sup>19</sup> fondet e investimit janë të ekspozuara kryesisht ndaj tregut vendas të obligacioneve sovraane. Disa fonde që kanë nisur kohët e fundit investojnë në obligacione sovraane të huaja dhe obligacione të korporatave, si dhe në aksione të huaja, por ato mbeten në nivele të vogla. Ndërlidhja e fondeve brenda sektorit financiar varet kryesisht nga bankat. Po sipas një vlerësimi të bërë nga FMN<sup>20</sup> madhësia relativisht e vogël e këtij sektori në vendin tonë, shkalla e ulët e ndërlidhjes së tij me pjesën tjetër të sektorit financiar, baza e qëndrueshme e investitorëve janë zbutës të rëndësishëm të riskut.

Sektori i titujve dhe një pjesë e konsiderueshme e biznesit (këshillimi për investime, ndërmjetësimi/brokerimi, shërbimet e kujdestarisë) kryhet nga bankat. Bankat që kryenin këto shërbime janë të vetëdijshme për rreziqet e PP/TF dhe zbatojnë masa për të zbutur këto rreziqe.

<sup>19</sup> Albania: Technical Assistance Report—Investment Funds and Interconnectedness Risks; IMF Country Report No. 23

<sup>20</sup> Si më sipër.

### 4.3 Tregu i sigurimeve

Në tregun e sigurimeve gjatë vitit 2022 kanë ushtruar veprimtarinë e tyre 12 shoqëri sigurimi Jetë dhe Jo-Jetë. Pesha që zë vlera e aktiveve të këtij tregu në raport me PBB është 2.04%.

Shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë e sigurimeve në Shqipëri ndahen në tre kategori: Sigurim jete, Sigurim jo-jete dhe Risigurimi. Tetë shoqëri sigurimesh ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e jo-jetës dhe katër në sigurimet e Jetës. Një nga shoqëritë e jo-jetës është gjithashtu e licencuar për të ushtruar edhe aktivitetin e risigurimit. Krahas shoqërive të sigurimit, në tregun e sigurimeve ushtrojnë aktivitetin e tyre edhe ndërmjetësit në sigurime (broker në sigurime dhe agjentë në sigurime).

#### ▪ Risku i sektorit të sigurimeve

Gjatë periudhës objekt vlerësimi, nga të dhënat e raporteve të aktivitetit të dyshimtë (RAD) të raportuara në AIF nuk ka raste të raportuara nga ky sektor.

Për më tej edhe nga organet ligjzbatuese nuk raportohen raste të pastrimit të parave të lidhura me këtë sektor.

Cënueshmëria e industrisë së sigurimeve ndaj pastrimit të parave mbetet e ulët si shkak e disa faktorëve, si p.sh. policat për sigurimin e pronës, viktimave, shëndetit zakonisht nuk ofrojnë veçori specifike për fshehjen dhe lëvizjen e parave.

Parimisht rreziqet kryesore të pastrimit të parave lidhen me rastet kur financuesi është i ndryshëm nga përfituesi i policës së sigurimit ose kryhen pagesa nga jashtë vendit për llogari të klientit. Ndërsa llojet e produkteve që përfaqësojnë potencialisht rreziqet kryesore të PP/TF janë produktet me një periudhë të shkurtër maturimi dhe ato me mundësi përfundimi të parakohshëm të policës.

#### ▪ Cënueshmëria

Në kuadër të vlerësimit të cënueshmërive duhet të mbahet në konsideratë natyra dhe materialiteti i këtij sektori. Kështu të gjitha veprimet për këtë sektor kryhet nëpërmjet bankave çka përbën një element zbutës të cënueshmërisë ndaj riskut PP. Një pjesë e konsiderueshme e veprimtarisë së këtij sektori është sigurimi i detyruar në kuadër të marrjes së kredive bankare dhe siguracioni i detyruar i punonjësve të institucioneve shtetërore dhe private.

#### 4.4 Sektori financiar jobankë

Sektori financiar jobankë në Shqipëri përbëhet nga 3 nënndarje kryesore: Subjekte financiare jobanka, Shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre dhe Zyrat e këmbimit valutor.

##### ▪ **Produktet e sektorit financiar jobankë**

Në Shqipëri në vitin 2022 operojnë 38 subjekte financiare jobanka të cilat janë të licencuara për ofrimin e një ose më shumë shërbimeve nga 8 produktet/veprimtaritë financiare të lejuara nga Banka e Shqipërisë. 29% e subjekteve ofrojnë Qira Financiare, 24% Kredidhënie dhe E-Money, 21% Veprimtari të shërbimit të pagesës dhe transferimit të parave, 18% Mikrokredi dhe Faktoring, 13% Shërbime të këmbimit valutor etj. Nga 38 subjekte, 27 prej tyre ofron vetëm një produkt/veprimtari financiare, 6 prej tyre ofrojnë tre produkte/veprimtari financiare, 3 prej tyre ofrojnë dy veprimtari financiare, 1 subjekt financiar ofron katër dhe 1 subjekt financiar ofron pesë produkte/veprimtari financiare. Aktiviteti kryesor i institucioneve financiare jobanka është ai kreditues, i ndjekur nga pagesat dhe transfertat<sup>21</sup>.

##### ▪ **Cënueshmëria**

Institucionet financiare jobanka, janë të angazhuara në veprimtarinë e huadhënies (kreditimit, mikrokredisë, qiradhënies financiare, financimi i faturave - factoring), transfertave dhe pagesave dhe këmbim valutor. Gama e gjerë e produkteve dhe shërbimeve të sektorit të ofruara nga ky sektor çojnë në lloje dhe nivele të ndryshme të rreziqeve të PP/TF.

Referuar huadhënies së këtyre subjekteve për klientët e tyre, vlen të përmendet se pjesa më e madhe e transaksioneve kanalizohet nëpërmjet sistemit bankar, çka përbën një element zbutës të cënueshmërisë ndaj riskut PP.

Transfertat (dërgesat) e parave dhe veprimtaria e këmbimit valutor ekspozohen ndaj riskut të PP pasi kemi të bëjmë me transaksione ndërkufitare apo veprime që kryhen kryesisht në cash.

Për sa i përket zyrave të këmbimit valutor nuk është evidentuar ndonjë risk specifik por natyra e biznesit lidhur me përdorimin e cash, por edhe kuptueshmëria ende jo në nivelin e duhur për detyrimet dhe risqet për PP/FT mund të konsiderohen si elementë që rrisin cënueshmërinë.

Brenda sektorit financiar jobankë, subjektet që ofrojnë transferimin e parave paraqesin një risk të shtuar për pastrim parash, për një sërë arsyesh:

---

<sup>21</sup>[https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime\\_Periodike/Raporti\\_i\\_Stabilitetit\\_Financiar/Raporti\\_i\\_Stabilitetit\\_Financiar\\_per\\_gjashte\\_mujorin\\_e\\_dyte\\_te\\_vitit\\_2022.html](https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_Periodike/Raporti_i_Stabilitetit_Financiar/Raporti_i_Stabilitetit_Financiar_per_gjashte_mujorin_e_dyte_te_vitit_2022.html)

- Shërbime globale të ofruara dhe lëvizja e shpejtë e fondeve edhe në vende të konsideruara me risk;
- Numri relativisht i lartë i transfertave të kryera në shuma të vogla, ku kjo e bën të vështirë zbulimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me PP/FT;
- Numri i lartë i agjentëve që ofrojnë shërbimin e transfertave monetare, si dhe mundësia e përfshirjes së vetë agjentëve në skema të dyshimta;
- Mungesa e njohurive në nivelin e duhur në fushën e PP/FT të agjentëve të shoqërive që ofrojnë shërbimin e transfertave monetare, pavarësisht trajnimeve të ndërrmarra;
- Koha e kufizuar për monitorimin e vazhdueshëm për zhvillimin e profilit të klientëve ku dominojnë rastësorët, ndërkohë që numri i transfertave është relativisht i lartë;
- Shtrirja e gjerë gjeografike e rrjetit të agjentëve në të gjithë territorin e vendit;
- Numri relativisht i lartë i dërgesave;
- Kombinimi i transfertave me këmbimet valutore.

#### **4.5 Mjetet Virtuale dhe Paraja elektronike**

##### **▪ Mjetet Virtuale**

Në vitin 2020, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë. Objekti i ligjit është rregullimi i emetimit të xhitonëve digjitalë dhe/ose të monedhave virtuale, licencimi, monitorimi dhe mbikëqyrja e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e shpërndarjes, tregtimit e ruajtjes së tokenëve digjitalë dhe/ose monedhave virtuale, të agjentit të tokenëve digjitalë, ofruesit të shërbime inovative dhe sipërmarrjes së automatizuar të investimeve kolektive.

Në vijim të miratimit të ligjit 66/2020, autoritetet mbikëqyrëse, përkatësisht Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Autoriteti Kombëtar për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) kanë hartuar dhe miratuar aktet nënligjore në zbatim të ligjit 66/2020, rregulloret për mjaftueshmërinë e kapitalit të këtyre subjekteve, për procedurat e likuidimit vullnetar dhe të detyrueshëm, tarifatat përkatëse të licencimit dhe mbikëqyrjes si dhe mirëmbajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuar.

##### **▪ Të dhëna për periudhën 2019-2022**

Aktualisht në vendin tonë nuk rezultojnë subjekte të licencuara si ofrues të mjeteve virtuale por në këtë kuadër vlen të parashtrijmë se:

- Si mjet pagese është e vështirë të realizohet në vendin tonë. P.sh nëse synohet blerje pasurie e paluajtshme dhe disponohet kriptomonedhë, kjo duhet të këmbetet paraprakisht në FIAT pasi pagesa duhet të kryhet në këtë lloj mjeti . Edhe Kasino brenda nuk ofrojnë mundësinë e përdorimit të kriptomonedhave. Shërbimet nga një

sërë profesionistësh pranohen me pagesa elektronike nëpërmjet kartave dhe llogarive bankare, pra në monedha të njohura.

- Rezultojnë raste jo të shpeshta të investimit nga klientë të bankave shqiptare të fondeve të tyre në mjete virtuale, përmes platformave jashtë vendit që ofrojnë këtë mundësi, por nga bankat raportohet se për asetet virtuale në vitin e fundit kemi ulje të kërkesave të transaksioneve me kriptot, kjo për shkak të politikave shtrënguese të bankave.

#### ▪ **Masa reaguese**

Me qëllim zbutjen e risqeve në këtë fushë janë ndërmarrë disa masa si: Përgatitja e një kuadri ligjor, përgatitja dhe publikimi i tipologjive ndërkombëtare nga AIF, realizimi i trajnimeve bazike me pjesëmarrës nga AIF, Policia e Shtetit, AMF dhe sektori bankar, realizimi i trajnimeve të avancuara me pjesëmarrje nga përfaqësues të AMF, AIF, Policisë së Shtetit, masa edhe në kuadër të identifikimit të ushtrimit të palicencuar të kësaj veprimtarie.

#### ▪ **Konkluzion**

Në kuadër të përafrimit me standardet ndërkombëtare dhe forcimin e kornizës PPP/FT, në Shqipëri janë ndërmarrë masa legjislative për mjetet virtuale dhe ofruesit e shërbimeve të mjeteve virtuale si: përfshirja si subjekt i po këtij ligji të PF tregtar dhe juridik të ofruesve të shërbimeve të mjeteve virtuale, miratimi i një kuadri ligjor për rregullimin e këtij sektori i cili përmban edhe detyrime në kuadër të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjithashtu vihet re se janë ndërmarrë disa masa nga autoritetet për evidentimin e rasteve të ushtrimit të palicencuar të veprimtarisë së ofruesit të shërbimeve të mjeteve virtuale.

Siç është përmendur më sipër nga të dhënat e administruara dhe analizuara rezultuan raste sporadike të përdorimit të mjeteve virtuale (si produkt) për pastrim parash. Gjithsesi cënueshmëria potenciale e sistemit është domethënëse, siç rezulton në një sërë vendesh të tjera për shkak të karakteristikave dhe trendeve të këtij sektori në nivel ndërkombëtar.

#### ➤ **Sektori i ofrimit të parasë elektronike**

Në Shqipëri në vitin 2022 për shërbimin e parasë elektronike (E-Money) janë regjistruar 9 subjekte por 6 prej tyre ofrojnë vetëm këtë shërbim.

Shërbimet kryesore të ofruara nga subjektet e parasë elektronike janë: Pagesa utilitare, Pagesa të biletave dhe shërbimeve e-commerce, pagesa të kësteve të mikrokredive, pagesa siguracionesh, disbursim kredie dhe transfertat kombëtare dhe ndërkombëtare. Shërbimet e lëvrimit të kredive dhe transfertat ndërkombëtare ofrohen nga 2 subjekte.

## ▪ **Konkluzion**

Nga kryqëzimi i të dhënave sektori i pagesave elektronike është një sektor me risk për pastrim parash duke marrë në konsideratë mënyrën e operimit, por në Shqipëri është ende në zhvillim e sipër dhe risku i keqpërdorimit për pastrim parash është i ulët. Gjithsesi ky sektor vlerësohet që në vijim të jetë në fokusin e autoriteteve mbikëqyrëse në lidhje me zbatueshmërinë e masave në kuadër të PP/FT (monitorimi i vazhdueshëm i klientit transaksioneve, identifikimit, procedurave dhe politikave të ndjekura) nëpërmjet shpërndarjes së tipologjive, udhëzimeve specifike edhe inspektimeve në vend apo në distancë.

### **4.6 Bizneset dhe profesionet jofinanciare**

Sektori i bizneset dhe profesionet jofinanciare përbëhet nga Noterë, Avokat, Lojërat e Fatit/Kazino, Auditues ligjor, Kontabilist të Miratuar, Ndërmjetës të Pasurive të Paluajtshme dhe Tregtarët e Metaleve dhe Gurëve të Çmuar.

Gjithashtu janë marrë në analizë edhe sektori i tregtimit të mjeteve motorike.

## ▪ **Konkluzion**

Duke marrë në konsideratë cënueshmërinë, gjurmimin dhe kontrollet, fushat ekonomike të përdorura për pastrim parash si dhe tipologjitë e disponueshme, shërbimet e ofruara, vlerësohet se auditues ligjor, kontabilist i miratuar, lojërat e fatit/kazino, sektori i tregtimit të mjeteve motorike, ndërmjetës të pasurive të paluajtshme, shfaqin nivel risku mesatar për PP, noterët nivel të lartë dhe kategoritë e tjera të sipërpërmendura të ulët.

Për më tej përveç sa u citua më sipër vlen të përmendet se mungesa apo RAD e limituara nga një pjesë e kësaj kategorie (Auditues Ligjor/Kontabilist i Miratuar, Lojërat e Fatit/Kazino, Ndërmjetësit e Pasurive të Paluajtshme), nuk zbeh progresin në mbledhje, mbajtje dhe ruajtje dokumentacioni të siguar në kuadër të masave të vigjilencës së duhur/zgjeruar, të dhëna këto të vlefshme në raste investigimesh dhe hetimesh.

#### **4.6.1 Truste ose Kompanitë e ofrimit të shërbimeve**

TCSP<sup>22</sup> nuk njihen si lloj biznesi i posaçëm në Shqipëri dhe nuk ka licencim të posaçëm gjithashtu. Gjithsesi në ligjin PP/FT, neni 3 germa “ll” parashikohen si subjekte edhe çdo person fizik ose juridik, përveç atyre të specifikuar më sipër, të cilët ofrojnë për një klient shërbimet si më poshtë:

- i. vepron si agent formimi i personave juridikë;

---

<sup>22</sup> Trust or Company Service Provider.

- ii. vepron ose cakton dikë tjetër të veprojë si një drejtor ose administrator i një personi juridik, pjesëtar i një ortakërie apo një pozitë të ngjashme lidhur me persona të tjerë juridikë;
- iii. siguron një zyrë të regjistruar, akomodim ose adresë për biznesin, adresë zyrtare ose me korrespondencë për një shoqëri tregtare, partneritet, person juridik apo organizime ligjore;
- iv. vepron ose cakton dikë tjetër të veprojë si i besuar i një organizimi ligjor ose kryen funksion ekuivalent për një formë tjetër organizimi ligjor;
- v. vepron ose cakton dikë tjetër të veprojë si një aksionar dhe/ose ortak i shoqërive që kanë aksione të mbajtësit për një person tjetër.

Në praktikë, një pjesë e shërbimeve të paraqitura më sipër ofrohen deri diku nga avokatët dhe kontabilistët.

## **V: RISKU NGA FINANCIMI I TERRORIZMIT**

### **5.1 Panoramë e Përgjithshme**

Paralelisht me vlerësimin e riskut të pastrimit të parave, është bërë një vlerësim i faktorëve të riskut të lidhur me financimin e terrorizmit. Edhe pse nuk ka lidhje direkte midis këtyre dy faktorëve, paraqesin elementë të përbashkëta si. p.sh financimi i terrorizmit mund të jetë fryt i aktiviteteve kriminale nga përfitimi i paligjshëm i veprave kryesore të pastrimit të parave, si prodhimi/trafikimi i lëndëve narkotike, krimi i organizuar, etj.

Ky vlerësimi i riskut merr në konsideratë një sërë elementësh si: Homogjeniteti i popullsisë, pozicioni gjeografik, ekonomia shqiptare, madhësia e sektorit financiar dhe jo financiar në vend, aksesimi në shërbime financiare, informaliteti në Shqipëri, numri i akteve terroriste në vend, situata në rajon, kërkesa të ardhura dhe të dërguara, RAD dërguar në AIF, metodat e njohura të financimit të terrorizmit etj.

### **5.2 Sektori i Organizatave jofitimprurëse (OJF)**

Sektori i Organizatave jofitimprurëse (OJF) luan një rol të rëndësishëm në nivel ndërkombëtar, përfshirë në fushën e ofrimit të shërbimeve për individë apo grupe shoqërore në nevojë. Ky kontribut sigurohet nëpërmjet dhurimeve që ofrohen në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe një vend të veçantë në aktivitetin e tyre zë besimi që ato krijojnë në komunitetet përkatëse. Një pjesë e OJF, për vetë veçorinë e punës, përveç se mbledhin fonde për qëllime bamirësie, kulturore, arsimore, sociale, ose për kryerjen e llojeve të tjera të ‘punëve të mira’, janë të angazhuara edhe në shpërndarje fondesh apo financime, për shtresa apo grupe të caktuara shoqërore, procese këto që mund të përbëjnë një rrezik potencial ekspozimi ndaj abuzimit apo keqpërdorimit për qëllime të pastrimit të parave apo dhe financimit të terrorizmit.

Abuzimi apo keqpërdorimi i organizatave jofitimprurëse për qëllime terroriste mund të marrë forma të ndryshme, përfshirë ngritjen e një organizate në dukje legjitime jofitimprurëse por me objektiva të paligjshëm, abuzimin e një organizate legjitime jofitimprurëse për të financuar terrorizmin, apo edhe devijimin e parave të ndihmës nga projektet legjitime.

#### **▪ Të dhëna për OJF në Shqipëri**

Organizatave jofitimprurëse regjistrohen në administratën tatimore, pasi kanë kryer më parë regjistrimin, në përputhje me legjislacionin e fushës. (Themelimi, Regjistrimi në Gjykatë dhe në DPT). Deri në fund të 2023, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) ishin të regjistruara 5,903 organizata nga të cilat vetëm 2,474 kishin status aktiv.

### 5.3 Masat për zbutjen e risqeve në sektorin e OJF në vendin tonë

- Në përgjithësi, kuadri ligjor dhe rregullator për OJF në Shqipëri, konsiderohet si i përshtatshëm për të zbutur riskun e FT në këtë sektor. Kuadri ligjor i fushës paraqitet si më poshtë:
  - Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 19/2019 “Për mbikëqyrjen e organizatave jofitimprurëse në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;
  - Miratimi i ndryshimit të ligjit “Për procedurat tatimore” (viti 2019) lidhur me kërkesën e detyrueshme që OJF të kenë të paktën 1(një) llogari bankare dhe se çdo llogari bankare e OJF mbajtur në Shqipëri ose jashtë vendit duhet të deklarohet në organet tatimore;
  - Miratimi i ligjit nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” i cili parashikon krijimin e një regjistri elektronik të OJF, me të gjitha të dhënat e detajuara dhe të përditësuara rreth tyre si identiteti i themeluesve, organet vendimmarrëse, përfaqësuesit ligjore dhe informacione të tjera financiare të OJF. Regjistri do të administrohet nga Gjykata e Tiranës;
  - Miratimi i ligjit nr. 112/2020 “Për regjistrin e pronarit përfitues” dhe VKM nr. 1088, datë 24.12.2020 ‘Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit e publikimit të të dhënave për pronarët përfitues’, sipas të cilave çdo subjekt raportues ekzistues, organizatë jofitimprurëse, i regjistruar në Gjykatë dhe organet tatimore dhe identifikuar me NIPT, duhet të regjistrojë pronarin/ët përfitues në Regjistrin e Pronarëve Përfitues;
  - Miratimi i ligjit nr. 154/2020 “Për regjistrin qendror të llogarive bankare” sipas të cilit është ngritur dhe funksionon si një bazë e të dhënave shtetërore, regjistri i llogarive bankare në të cilin regjistrohen e ruhen të dhënat në lidhje me numrin e llogarisë bankare dhe kodin IBAN të llogarisë në rastet kur është llogari bankare, emrin e institucionit financiar që mban llogarinë bankare ose kasetën e sigurisë, emrin, mbiemrin, datëlindjen, shtetësinë dhe adresën e përhershme të çdo individit që ka përfitim në llogari dhe/ose që është person i lidhur me mbajtësin e llogarisë, etj.;
- Hartimi i një metodologjie risku për OJF në bashkëpunim shoqërinë civile dhe marrja në konsideratë e saj nga DPT si një nga elementët/dokumentet në funksion të mbikëqyrjes së OJF;
- Kërkesat e regjistrimit dhe informacionit për OJF janë kryesisht në përputhje me kërkesat e rekomandimit 8 FATF, i vlerësuar si gjerësisht i përmbushur në vitin 2019;
- Masat për marrjen dhe shkëmbimin e informacionit, hetimeve dhe inteligjencës janë të duhura. Megjithatë, autoritetet përgjegjëse për regjistrimin dhe mbikëqyrjen e OJF (autoritetet tatimore dhe Regjistri i OJF ) mund të kenë burime njerëzore të kufizuara, të dedikuara apo specializuara për mbikëqyrjen apo regjistrimi e OJF.

## ▪ Vlerësimi i cënueshmërisë

Faktorët që ndikojnë në cënueshmëri (dobësitë) të sistemit dhe mund të shfrytëzohen apo mund të lehtësojnë veprimtarinë e OJF:

- Vlerësohet se nuk ka faktorë kyç që vërtetojnë lidhjen me rreziqet e FT por një faktor potencial rreziku mund të jetë vendndodhja ku funksionojnë këto OJF;
- Për sa i përket mbikëqyrjes nga organet tatimore janë konstatuar përmirësime në këtë aspekt por vlerësohet nevoja për ecuri të mëtejshme duke specializuar personelin për mbikëqyrjen dhe inspektimin e tyre;
- Nevoja për trajnime të vazhdueshme dhe përditësime në lidhje me risqet për financim terrorizmi për këtë kategori në sektorin publik dhe privat;
- Nevoja për trajnime dhe/ose udhëzues të mëtejshëm për ndërgjegjësimin e OJF lidhur me rreziqet e mundshme të abuzimit apo keqpërdorimit të lidhur me financimin e terrorizmit.

### **5.4 Konkluzione për riskun e abuzimit/keqpërdorimit të OJF për financim terrorizmi**

Vlerësimi dhe analizimi i kuadrit ligjor, situatës së përgjithshme të sigurisë, skenarëve të kërcënimit për financimin e terrorizmit në tërësi por edhe në lidhje me sektorin e OJF ka nxjerrë në pah se nuk ka të dhëna për:

- OJF të themeluara në vendin tonë që veprojnë në zona konfliktesh (të lidhura me terrorizmin) apo zona kufitare të tyre;
- OJF të përfshira në financime dhe rekrutim individësh në zonat e konflikteve;
- Raste të dyshimta të përfshirjes abuzimit apo keqpërdorimit të OJF që janë regjistruar apo veprojnë në Shqipëri, për mbledhje të fondeve për financimin e terrorizmit.

Për sa i përket zbutjes së risqeve për këtë sektor, janë ndërmarrë disa iniciativa që lidhen me krijimin e një regjistri në funksion të transparencës së veprimtarisë së tyre, vendosja e detyrimit për të pasur një llogari bankare, deklarimi i një llogarie të tillë në administratën tatimore, hartimi dhe zbatimi i një metodologjie risku për mbikëqyrjen e tyre, krijimi i regjistrit të pronarit përfitues, etj. Të dhënat e analizuar tregojnë për një risk të ulët të financimit të terrorizmit të lidhur me abuzimin apo keqpërdorimin e OJF.

### **5.5 Cënueshmëria e përgjithshme e sistemit në kuadër të risqeve të terrorizmit dhe financimit të terrorizmit**

Nga tërësia e të dhënave të analizuar më sipër rezulton se janë ndërmarrë masat e mëposhtme:

- Është realizuar dhe zbatohet Strategjia Kombëtare kundër Terrorizmit ku janë përfshirë një sërë institucionesh, në të cilën përfshihet gjithashtu edhe strategjia ndër sektoriale për

Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit, si dhe planeve përkatëse të veprimit;

- Shqipëria ka nënshkruar dhe po zbaton disa marrëveshje bashkëpunimi me vende të rajonit, Evropës dhe SHBA, në fushën e sigurisë dhe shkëmbimit të informacionit për verifikimin dhe luftën kundër terrorizmit;
- Vihet re një ndërgjegjësimit në nivelin e duhur të subjekteve raportuese për riskun nga financimi i terrorizmit dhe kryesisht sistemi bankar është i pajisur me platforma specifike në të cilat janë përfshirë listat e personave të shpallur, në bazë të cilave zbatojnë programet e vigjilencës dhe monitorimit të transaksioneve;
- Në kuadër të inspektimeve të realizuara nga mbikëqyrësit e subjekteve të ligjit, një nga pikat e programit është pikërisht masat në kuadër të financimit të terrorizmit, duke kryer kontrole për aksesin në listat e personave të shpallur, mbajtja e tyre të përditësuara, etj;
- Strukturat e antiterrorit në Policinë e Shtetit tashmë kanë kapacitetet operacionale, logjistikën e nevojshme për kryerjen e operacioneve speciale të cilat ndihmojnë në parandalimin dhe goditjen e veprave penale me karakter terrorist. Njëkohësisht punohet vazhdimisht për përsosjen e mëtejshme të këtyre kapaciteteve në bashkëpunim me misionet policore që veprojnë prej vitesh në vendin tonë si PAMECA V dhe ICITAP. Në brendësi të strukturës së mësipërme është krijuar edhe një sektor i posaçëm vetëm për hetimin financiar të veprave që lidhen me terrorizmin;
- Për penalizimin dhe ndëshkimin e terrorizmit, strukturat e specializuara të luftës kundër terrorizmit, në vazhdimësi e kanë trajtuar e ndjekur fenomenin e luftëtarëve të huaj terroristë dhe janë zhvilluar hetime për individë organizatorë, financues dhe pjesëmarrës në konflikte jashtë vendit;
- Realizimin e hetimeve financiare për çdo vepër penale të lidhur me terrorizmin;
- Kontrollat kufitare nga Policia e Shtetit për të evidentuar migrantët e paligjshëm konsiderohen të përshtatshme, proces i cili, për disa pika në vijë tokësore kufitare, është i mbështetur edhe nga Frontex;

#### **Faktorët që ndikojnë në cënueshmëri (dobësitë) të sistemit dhe mund të shfrytëzohen apo mund të lehtësojnë veprimtarinë e terrorizmit/financimit të terrorizmit**

- Pozicioni gjeostrategjik i Shqipërisë mund të shfrytëzohet si një pikë tranziti jo vetëm për trafiqet e paligjshme, por dhe si kanal për tranzit personash që mund të kenë lidhje me terrorizmin;
- Prania e rasteve edhe pse të rralla, të individëve që mbështesin ose promovojnë ekstremizmin e dhunshëm;
- Riatdhesimi në Shqipëri i familjarëve të disa LHT që i janë bashkuar konfliktit në Siri vite me parë, përveç përbën një aspekt humanitar, potencialisht mund të ketë rreziqe që këta persona të përhapin ideologji ekstremiste;

- Ngjarje sporadike (dënime për nxitje, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste, ekstradimin drejt vendeve të huaja të individëve të kërkuar për veprimtari të lidhura me terrorizmin) mund të jenë tregues për të ardhmen si element risku i lidhur me terrorizmin apo financimin e terrorizmit;
- Duke marrë në konsideratë rëndësinë e posaçme që paraqet kjo fushë, trajnimet e vazhdueshme për agjencitë ligjzbatuese, subjekteve të ligjit dhe organet mbikëqyrëse, mbeten objektiv.

## **5.6 Konkluzione për riskun e terrorizmit dhe financimit të terrorizmit**

Siç është evidentuar më sipër Shqipëria nuk ka qenë e prekur nga akte terroriste por kjo nuk e bën imun vendin tonë nga rreziku i terrorizmit apo ekstremizmit/radikalizmit që çon në terrorizëm, marrë në konsideratë këtu zhvillimet në nivel ndërkombëtar, përhapjen me ritme të shpejta të propagandës dhe ekstremizmit nëpërmjet rrjeteve sociale dhe rreziqet potenciale nga të rikthyerit nga zonat e konfliktit.

Shqipëria është ndër vendet e para të renditura në koalicionin kundër terrorizmit, përgjatë viteve ka përmirësuar legjislacionin si dhe ka ngritur kapacitete të reja të specializuara për të adresuar këtë fenomen.

Të dhënat e analizuara tregojnë për një risk të ulët në mesatar të riskut të financimit të terrorizmit në vend.

## **VI: ARMËT E SHKATËRRIMIT NË MASË**

Në tetor 2020, FATF rishikoi Rekomandimin (R.1) dhe Shënimin Interpretues të R.1 të standardeve të tyre globale për luftën kundër krimit financiar. Sipas rekomandimit të amenduar, vendet duhet të identifikojnë, vlerësojnë, kuptojnë dhe të marrin masa për të zbutur rreziqet që lidhen me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.

Në kuadrin të Rekomandimit 1, “Risku i financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit masë” i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë vetëm shkeljes, moszbatimit ose shmangies së mundshme të detyrimeve të sanksioneve financiare të parashikuara në Rekomandimin 7<sup>23</sup>.

Termi “Armët e Shkatërrimit në Masë” sipas strategjisë kombëtare<sup>24</sup>, përkufizohet si një armë me kapacitet shkatërrimi të lartë që shkakton dëme në shkallë të gjerë në njerëz, infrastrukturë dhe burime të tjera. Në to përfshihen armët kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore.

Ndërsa termi “Përhapja e Armëve të Shkatërrimit në Masë” nënkupton të gjitha përpjekjet e shteteve apo aktorëve jo shtetërorë, për të zhvilluar, për të blerë, për të prodhuar, për të zotëruar, për të transportuar, për të transferuar apo për të përdorur armët e shkatërrimit në masë ose pajisje dhe mjete të shpërndarjes, mallra me përdorim të dyfishtë apo mallra dhe teknologji që lidhen me të.

### **6.1 Masat zbutëse**

Masat e marra në Shqipëri janë:

- Ndërgjegjësim nëpërmjet trajnimeve të sektorit privat dhe publikimeve të tipologjive ndërkombëtare në faqen zyrtare të AIF por edhe nëpërmjet inspektimeve të realizuara ku ndër masat e verifikuara janë edhe respektimi i detyrimeve në kuadër të sanksioneve ndërkombëtare nga subjektet e ligjit. Kështu për periudhën 2020-2021 janë informuar/trajnuar për masat në lidhje me sanksionet financiare rreth 3,662 individë/punonjës pranë entitetet raportuese;
- Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme nga përfaqësues së Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE) për licencimin e import-eksport të mallrave me përdorim të dyfishtë;
- Miratimi i një Strategjie Kombëtare (sipërpërmendur) me masa konkrete;
- Ekzistenca e mekanizmave kombëtare për parandalimin e financimit të armëve të shkatërrimit në masë;

<sup>23</sup> Rekomandimi 7 : Vendet duhet të zbatojnë sanksione specifike financiare në përputhje me Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me parandalimin, goditjen, shtypjen dhe pengimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe financimin e tyre. Këto rezoluta u kërkojnë vendeve të ngrijnë pa vonësë fondet apo pasuritë e tjera dhe të sigurohen se nuk ka fonde apo pasuri të tjera në dispozicion, drejtpërdrejt ose indirekt, drejt ose në përfitim të, çdo personi ose subjekti të shpallur nga, ose nën autoritetin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara bazuar në Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

<sup>24</sup> V.K.M Nr. 33, datë 22.1.2020 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për mospërhapjen e armëve të dëmtimit në masë dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.

- Miratimi një ligji specifik (ligji nr. 72/2019 “Për Masat Shtrënguese Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”);
- Një hap pozitiv që ndikon edhe në masat kundër armëve të shkatërrimit në masë është edhe krijimi dhe funksionimi i regjistrimit të pronarit përfitues, duke krijuar transparencë për kompanitë për sa i përket pronësisë përfituese duke kufizuar mundësinë e keqpërdorjes së tyre;
- Largësia gjeografike, tregtia në nivele minimale apo inekzistente, me vendet e listuara nga FATF që paraqesin shqetësime serioze mbi kërcënimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë<sup>25</sup> apo edhe vende të cilësuar me risk të lartë<sup>26</sup>;
- Politikat shtrënguese të sistemit financiar në lidhje me transaksionet e mundshme me këto vende.

## 6.2 Risku i mbetur dhe konkluzione

Shqipëria nuk zotëron apo zhvillon programe të armëve të shkatërrimit në masë dhe nuk ka kapacitete aktive të rëndësishme të industrisë kimike, dhe as objekte për kërkime bërthamore apo laboratorë biologjikë për testimin e substancave jashtëzakonisht të rrezikshme.

Shqipëria ka miratuar legjislacion të gjerë që synon parandalimin e përhapjes dhe financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, që është në përputhje me standardet dhe konventat ndërkombëtare. Lidhur me zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare për përhapjen, është miratuar ligji i veçantë “Për Masat Shtrënguese Ndërkombëtare”, i cili ka për qëllim vendosjen dhe zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare.

Subjektet e mëdha financiare, kryesisht Banka, përdorin sisteme për monitorimin automatik të transaksioneve dhe personave për të cilët janë vendosur masa shtrënguese financiare.

Për sa i përket eksportit, importit, ndërmjetësimin dhe tranzitit të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, ka një kuadër ligjor të gjerë dhe gjithashtu është ngritur dhe funksionon pranë Ministrisë së Brendshme AKSHE, e cila është struktura shtetërore përgjegjëse për transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake, të artikujve dhe të teknologjive me përdorim të dyfishtë.

Në periudhën e analizuar, subjektet nuk kanë dërguar asnjë RAD për financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe AIF në analizat e saj nuk ka identifikuar raste dhe dyshime për përhapjen e financimit të armëve të shkatërrimit në masë.

Bazuar në analizimin e kuadrit ligjor, të dhënave dhe informacionit të disponuar rezultoi një risk i nivelit të ulët për sa i përket riskut për financimin e armëve të shkatërrimit në masë në vendin tonë.

---

<sup>25</sup> Korea e Veriut

<sup>26</sup> Irani